

**2 Komisioni Federal për Migracion kërkon: Mundësi për një shoqëri të drejtë për të gjithë!**

**3 Votimet federale të 28 nëntorit 2021 Fitore historike për personelin e kujdesit në Zvicër**

**4 Bota e punës dhe sindikatat në Kosovë Nevojitet solidarizim, reforma dhe fuqizim i sindikatave**

Nr. 7 | dhjetor 2021 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Mbështetje e madhe për kurir\*et grevist\*e

## 12 247 njerëz kërkojnë: Smood, dëgjo kurir\*et tuaj!



Pamje nga greva aktuale e kurir:eve të Smood në njërin nga qytetet e Zvicrës

Që nga 2 nëntori janë në grevë kurir\*et e shërbimit të dërgesave Smood – në ndërkohë në 11 qytete të Zvicrës perëndimore. Ata kërkojnë që të marri fund shfrytëzimi dhe kushte korrekte të punës. Mbështetja publike është e madhe: Një delegacion i grevist\*eve me 23 nëntor i kanë dorëzuar Smood-it një peticion, i cili është nënshkruar nga 12 247 persona. Smood duhet menjëherë të filloi të bisedoi me të punësuarit dhe sindikatat Unia e Syndicom.

### Hilmi Gashi

«Smood, dëgjo kurir\*et tuaja» thuhet në peticion, i cili brenda tri javësh është nënshkruar nga 12 247 në gjithë Zvicrën. Nënshkruarit theksojnë që kurir\*et kanë të drejtë në pagë dhe trajtim korrekt. Ata kërkojnë nga Smood veçanërisht një plan pune, i cili merr parasysh nevojat e kurir\*eve, që kurir\*et kanë të drejtë për pagë korrekte dhe pagimin e çdo ore pune, që të kompensohen për përdorimin e automjetit të tyre dhe që Smood të ulet në tryezën e bisedimeve me kurir\*et dhe me sindikatat e mandatuara nga ta.

### Grevist\*et vizitojnë Smood-in dhe Migros-in

Një delegacion i kurir\*eve grevistë nga e gjithë Zvicra perëndimore ka dorëzuar peticionin në selinë kryeso-

re të Smood në Plan-les-Ouates (GE) për CEO Marc Aeschlimann. Ata ngulin këmbë në kërkesat e tyre për bisedime të menjëhershme, për të përmirësuar kushtet e punës në Smood dhe që të shmangen ankesat e parregullsitë serioze. Edhe selisë së Migros-it në Gjenevë grevistët i bënë një vizitë dhe tërhoqën vërejtjen për situatën e padurueshme. Migros-i është pjesëmarrës me 35% dhe e përfaqësuar me dy quadro të larta të Migros Gjenevë në bordin e drejtorëve të në Smood.

### Mirënjohës për mbështetjen e madhe

«Ne në javët e fundit kemi marrë përkrahje të madhe nga popullata», thotë Farès, një kurir nga Montreux. «Që mbi 12 000 njerëz kanë nënshkruar peticionin në mbështetje

tonë, na bënë ne edhe më shumë me dije, se ne jemi duke zhvilluar një luftë të drejtë». Solidar me koleg\*et e tyre grevistë u tregua edhe Komisioni për Migracion i Unia, që në një rezolutë mbështesin luftën për paga më të mira, kushte korrekte dhe më të mira pune. Rezoluta iu është dorëzua grevist\*eve në Gjenevë përmes Veronique Polito, anëtare drejtorisë qendrore të Unia.

### Topi është tek Smood

Unia bashkë me Syndicom kërkon që Smood të filloi pa zvarritje bisedimet. Kurir\*et për ketë qëllim kanë zgjedhur delegacionin, i cili bashkë me sindikatat do të përfaqësohet karshi Smood-it. Gjendja e padurueshme tek Smood nuk lënë hapësirë për zvarritje të mëtejme.

### Kushtet e pasigurta të punës dhe qëndrimi kokëfortë i menaxhmentit çuan në grevë

Kurir\*et e Smood, shumë nga të cilët migrant\*et, kryejnë përditë dërgesa ushqimesh dhe produktesh të Migros-it – nën kushte jashtëzakonisht të vështira pune: paga të ulëta, mbulim tejet i ulët i shpenzimeve, trajtim jo transparent i bakshisheve nga kompania, mungesë e regjistrimit të orëve të punës. Edhe përkundër shumë intervenimeve tek drejtoria e ndërmarrjes që nga fillimi i tetorit, Smood deri më tani nuk ka treguar gatishmëri që të korrigjoj problemet e adresuara të punonjësve. Për tu dëgjuar zëri i tyre, të punësuarit në shume vende të Zvicrës kanë hyrë në grevë.

### Editorial



### Të dashur\*a lexues\*e

Na bie të shpesh të dëgjojmë «Është koha për më shumë solidarizim». Dhe unë i shtroi pyetjen vetes se për cilin solidarizim flasim ne? Pasi në solidarizimin në jetën tonë e përjetojmë në mënyra të ndryshe. Në përditshmërinë tonë, fjala është para së gjithash për mbështetjen e të dobëtëve. Por, kur ne ftojme për solidarizim në sindikatë, solidarizimi domethënë lufta e përbashkët për kushte pune e jetese me dinjitet njerëzor- Solidarizimi për ne është një shprehje luftarake.

Pabarazia po rritet, shumë veta humbin vendin e tyre të punës, migrant\*et humbin edhe lejen e tyre kur e humbin vendin e punës, edhe në Zvicër gjithnjë e më shumë njerëz janë të prekur nga varfëria dhe kanë pasiguri ekzistenciale. Njerëzit vdesin përditë në kufijtë e jashtëm të BE-së. Në vend se vaksinat të bëhen të mira publike globale, vendet e pasura kanë siguruar për veti pjesën e luanit.

Që nga 2 nëntori janë në grevë kurir\*et e shërbimit të dërgesave Smood – në ndërkohë në 11 qytete të Zvicrës perëndimore. Argumentet e mira vetëm si të tilla nuk po u ndihmojnë punonjësve në bisedime që të realizojnë interesat e tyre. Greva mbetet mjeti i fundit me ndikim të plotë. Punonjësit e Smood luftojnë për ti dhënë fund shfrytëzimit dhe për kushte korrekte pune. Solidarizimi me grevist\*et është i madh dhe ka një kuptim të rëndësishëm. Solidarizimi me grevist\*et do të fuqizojë pozitën e punëmarrës\*eve në bisedime dhe në shoqëri dhe do të jenë inkurajues për punonjësit tjerë që të përdorin këtë mjet ndikues.

Ne mbështesim grevën e punëmarrës\*ve të Smood dhe shprehemi solidar me të gjitha kërkesat e tyre.

Ne urojmë për një vit të mbarë dhe solidar!

Emine Sariaslan

## News

## 18 dhjetori: dita ndërkombëtare e punëmarrës\*eve Sans-Papiers dhe familjeve të tyre

31 vite Konventë e OKB-së për punëtorët migrantë dhe Zvicra edhe më tej nuk e ka ndërmend që ta nënshkruajë atë...edhe përkundër faktit se konventa mbron migrant\*et punëmarrës\*eve dhe familjet e tyre pavarësisht statusit të qëndrimit nga shfrytëzimi dhe shkeljes së të drejtave të njeriut. Të mobilizohemi edhe sivjet dhe të përhapim lajmin: Rregullarizimi për të gjithë. Solidarizim mes punëmarrës\*eve, kushte të njëjta pune, page e jetese me e pa leje qëndrimi. Shumë regjione planifikojnë aktivitete me 18.12: Informohu!

## Me mijëra në rrugë për më shumë pagë, respekt e solidaritet

Të shtunën, më 30 tetor 2021, gjithsej 12'500 pjesëmarrës nga sektor të ndryshëm në 5 qytete ishin në rrugë. Me moton: «Tani është radha jonë! Pagë. Respekt. Solidaritet.» Kërkuar kushte më të mira pune si dhe mirënjohje për angazhimin e tyre gjatë pandemisë. Kërkesat konkrete janë: rritje korrekte të pagave dhe një pagë të 13 për të gjithë; asnjë rrogë nën 4000 franga; kontrata kolektive punë me detyrim të përgjithshëm, posaçërisht në profesionet shërbyese; s'ka rritje të moshës së pensionit për gra. Vania Alleva, kryetare e sindikatës Unia, në fjalimin e saj në Cyrih theksoi: Në hijen e pandemisë së Covid-19 mentalitetit zhvatës kërcënon të thellon edhe më tej hendekun social. Tani nevojitet një ndryshim thelbësor në politikë për më shumë drejtësi sociale!». Konfrontimet e ardhshme nëpër sektor nuk do të jenë të lehta, gjë që bënë më të rëndësishëm sinjalin e fuqishëm të së shtunës.

## Dëshmi e ridefinimit të sindikatave në Zvicër dhe luftës për përparim shoqëror



Më 25.11.2021 në Volkshaus Cyrih u bë promovimi i librit «Kthesa e madhe në lëvizjen sindikaliste» («Die grosse Wende in der Gewerkschaftsbewegung») të Vasco Pedrina dhe Hans Schäppi. Në sallën kaltër përplot të mbushur në Volkshaus Cyrih nën moderimin e Annette Hug, historiane dhe autore, mysafirët Vasco Pedrina, autor i librit dhe ish kryetar i Unia; Vania Alleva, kryetare e Unia; Chris Kelley, bashkë-drejtues i sektorit të ndërtimit në Unia; Antonin Rohdich, aktivist i lëvizjes klimatike, patën rastin ndër të tjera, bazuar në njohurit historike, të diskutojnë në mënyrë kritike sfidat dhe shanset me të cilat do të përballen sindikatat në dekadat e ardhshme.

## Peticion për njohje efektive të arsyeve të azilit, të cilat janë specifike për gratë, vajzat dhe njerëzit LGBTIQ+

Arsyet specifike të azilit të grave, vajzave dhe njerëzve LGBTIQ+ shpesh nuk njihen e pranohen. Procedurat e azilit nuk mundësojnë identifikim të viktimave të dhunës gjinore, apo viktima të tregtimit me njerëz, strukturat e akomodimit janë të pamjaftueshme dhe mungojnë masat mbështetëse. Megjithatë gjatë gjithë rrugëtimit migruar thuaja se i nënshtrohen dhunës sistematike: p.sh. dhunës seksuale të ushtruar nga trafikantët apo në kampet e refugjatëve, shfrytëzimi seksual apo puna e detyrueshme dhe robëria nga bandat trafikuese nëpër vendet transite, edhe në vendet evropiane, kërcënimi, trauma dhe rreziku për fëmijët e tyre. Unia është njëra nga të 180 organizatat në 14 vende të ndryshme të Evropës, që mbështesin peticionin. Nënshkruaj edhe Ti! [www.feministasylum.org](http://www.feministasylum.org)

## Takimi vjetor i Komisionit Federal për Migracion (EKM/CFM)

# «Zvicra: Një mundësi e një shoqërie (të drejtë) për të gjithë?» – Një kritikë migrante

Komisioni Federal për Migracion (KFM) ftoi me 8 nëntor në Bernë për takimin vjetor të tij. Në qendër të manifestimit u zuri vend pyetja: «Zvicra: Një mundësi e një shoqërie (të drejtë e të barabartë) për të gjithë?» Në referatet hyrëse dhe një tryezë diskutimi referues\*et treguan status qon e shanseve të barabarta dhe në këndvështrim me të kaluarën dhe në të ardhmen – kjo gjithmonë në relacion me fazat e ndryshme arsimore dhe tregut të punës. Ndonjëherë më mirë e ndonjëherë me pak mirë.

Artan Islamaj

Referatet e caktuara të takimit vjetor karakterizoheshin nga fakti, që stereotipat e migrant\*eve përforcohen dhe në përgjithësi mungon sensibilizimi përkitazi me gjuhën e temave të migracionit. Migrant\*et përshkruhen si të huaj dhe me të mangët, në shembullin që migrantet prore përshkruhen si pastuese. Këto janë kuptime dhe imazhe, të cilat në diskursin aktual, për shkak të karakterit të tyre negativ dhe të thjeshtuar, vlejnë si të tejkaluara.

Edhe ideja e çimentimit të historive të suksesit në Zvicër me shembuj të migrant\*eve me performancë të lartë është gjithashtu problematike. Shpesh bëhet një diferencim mes migrant\*eve, që duan të kontribuojnë – dhe atë me çdo kusht – dhe të tjerëve që nuk përpiqen. Mirëpo edhe përdorimi i fjalëve si «migrant\*ja im/e», «refugjatët tanë», për të folur për personat, të cilët i kanë mbështetur, nuk i përgjigjen sensibilizimit, të cilin njeriu e ka pritur nga EFM.

Megjithatë, kishte dy pika të ndritshme, gjegjësisht nga Mark Terkessidis (autor dhe ekspert migracioni) dhe Elke-Nicole Kappus (shtabi i barazisë së shanseve në PH të Luzernit), të cilët në referatet e tyre në parim ishin reflektues dhe gjithashtu në gjuhën e tyre nuk shfaqnin elemente paternaliste. Kjo përshtypje, në bisedën me ta pas mbarimit të manifestimit,



Pamje nga një manifestim i grupit të itneresit për migacion të Unia në Belinzona: Të gjithë njerëzit janë të njëjtë para ligjit (Neni 8 i Kushtetutës)

u fuqizua dhe mua ma rritën shpresën që, mënyra në të cilën ne flasim për migrant\*et tregon një sensibilizim dhe se ne më shumë duhet të flasim me migrant\*et, se sa të flasim për ta; pasi edhe në vet manifestimin vetëm pak veta nga ta ishin pjesëmarrës.

## Sesioni i grave

# Janë aprovuar 22 peticione për parlamentin nacional

Nga 29-30 tetor u zhvillua sesioni i grave i organizuar nga Aleanca F. Në sesionin egrave morën pjesë 246 gra me përvoja e preokupime të ndryshme. Ato megjithatë kanë të njëjtin qëllim: barazinë, trajtimin e barabartë, pa diskriminim.

Emine Sariasslan

Sesioni i parë i grave është zhvilluar para grevës së parë të grave në shkurt 1991. Ishte një platformë politike, në të cilën gratë kishin mundësinë të shpreheshin. Përndryshe, gratë në politikë janë tejet të nën përfaqësuar. Në sesionin egrave kanë rastin që të shprehen dhe të shtrojnë kërkesat e tyre.

Gratë në Zvicër në lëmi të ndryshme jetësore trajtohen në mënyrë të pabarabartë. Qoftë kjo në punë, në paga, në pensione, në punën e kujdesit, ose ato përjetojnë edhe dhunë fizike e psikike. Sesioni i grave forcon vetëdijen tonë, me ç' rast ne kemi mundësinë të ndryshojmë diçka. Pa ne, nuk ndryshon asgjë. Gra të ndryshme kanë thënë, nëse ne nuk kërkojmë të drejtat tona, ne ato thjeshtë nuk do ti fitojmë! Nëse ne duam një shoqëri të drejtë, ne duhet të marrim përgjegjësinë tonë në duart tona dhe duhet të angazhohemi për të kërkesat tona.

### Komisionet këshilluese paraprake

Kishte 8 komisione këshilluese. Komisioni për të drejtën e votimit të banor\*eve, komisioni për barazi në punë e siguri, komisioni për bujqësi, komisioni për ekonomi, komisioni për çështje juridike dhe mbrojtje nga dhuna, komisioni për digitalizim, komisioni për shëndetin seksual dhe medicinë gjinore si deh komisioni për njohjen e punës vullnetare dhe atë të kujdesit. Tek mundësitë e barabartë në vend të punës bëhej fjalë, që gratë për të njëjtën punë të marrin pagë të njëjtë dhe të kenë

të drejta të njëjta. Gjithashtu edhe tek pajtueshmëria e jetës familjare, kujdesi dhe profesioni. Një temë me rëndësi edhe për ne si sindikalist\*eve janë kushtet e pasigurta të të punësuarve në amvisni, të cilët nuk i nënshtrohen ligjit të punës. Një temë tjetër, e cila për mua si migrante është me rëndësi, është e drejta e votimit për banor\*et. Edhe pse shumë njerëz janë rritur apo edhe kanë lindur këtu, kanë obligime të njëjta, mirëpo jo edhe të drejta të njëjta dhe nuk mund të marrin pjesë në demokracinë tonë. Tema më emocionale ishte ajo e dhunës ndaj grave. Një pjesë e madhe e të gjitha grave në një formë apo tjetër e ka përjetuar atë. Qoftë fizike apo psikike. Çdo

e dyta grua përjeton dhunë seksiste. Vetëm këtë vit në tetor 2021 kishte 4 femicide në Zvicër. Në Zvicër në këtë fushë bëhet ende shumë pak. Ka shumë pak mbështetje në parandalim. Ne kemi, fjala bie, shumë pak shtëpi grash dhe akomodim mbrojtës. Mirëpo, siç u tha, mua më duken të gjitha temat që kemi diskutuar me rëndësi.

Në fund të sesionit janë aprovuar 22 peticione për parlamentin nacional. Parlamentar\*et, të cilat kanë marrë pjesë në sesionin e grave do ti ndjekin më tej zhvillimet rreth peticioneve në parlament. Ne pjesëmarrës\*et do të jemi vigjilent edhe më tej për kërkesat tona.



Pamje e njërit nga sisionet e grave në Parlamentin Federal të Zvicrës

## Kongresi i Grave i SGB/USS: për punë sindikale feministe

## Angazhim nxitës i përfshirjes politike dhe sindikale

Gra energjike, solidarizim, angazhim politik e shoqëror – këtë përjetuan mbi 200 delegate në Kongresin e Grave të Sindikatave të Bashkuara të Zvicrës (SGB/USS), i cili u zhvillua me 12 dhe 13 nëntor në Bernë. Njëzëri ato ftuan për një grevë feministe për vitin 2023. Ato shtrojnë kërkesa politike dhe kuptuan se sa i rëndësishëm është angazhimi personal: siç tregon historia e grave në sindikata, ato preokupohen me çështje grash tek kur gratë kanë marrë një rol aktiv.

Marília Mendes

Kongresi qysh në fillim ishte edukativ dhe me shumë inspirim. Historiana dhe ish sekretarja e SGB/USS Dore Heim tregoi se si sindikatat një kohë të gjatë ishin një domeni e dominuar nga burrat: Me përjashtim të një periudhe në fillim të shekullit të 20-të, gratë nuk kishin vend në sindikata deri në vitet 1970. Si pasojë: kushte të këqija pune. Pasi që sindikatat (mashkullore) luftonin punën e grave dhe vendonin për paga tejet të ulëta për to. Tek nga vitet e 80'ta gratë filluan të angazhohen aktivisht në sindikata dhe të luajnë një rol të rëndësishëm në sindikata dhe në politikën sindikaliste. Përmes kësaj preokupimit e tyre të drejta zunë një vend të dukshëm tek kërkesat sindikaliste. Dore Heim e bëri të qartë: «Përmirësimi i të drejtave të punëmarrëseve nuk ndodhin me tahmin, porse nga angazhimi i tyre sindikalist.» Një vetëdijësim i rëndësishëm edhe për migrant\*et: ne duhet të angazhohemi vet

për një politik migracioni më të mirë!

## Greva feministe 2023

Me plotë angazhim delegatet debatuan mbi preokupimet feministe dhe botën e punës si dhe morën vendime udhërrëfyese. Kështu, ato vendosën për një grevë feministe në vitin 2023. Dhe shtruan kërkesa: Shkurtim i orarit të punës në dobi të një pajtueshmërie mes punës profesionale dhe asaj familjare, kushte më të mira për punën e kujdesit, jo rritjes së moshës së pensionimit, një politikë migracioni të drejtë dhe me dinjitet njerëzor.

Shumë kërkesa dhe shumë punë para nesh. Mirëpo, para së gjithash kongresi ishte një shenjë e fuqishme e angazhimit feminist e sindikalistë dhe solidaritet!



Kongresi i grave të SGB/USS u zhvillua me 12 e 13 nëntor 2021 në Gurten

Photo: © Yoshiko Kusano für den SGB

## Votimet e 28 nëntorit 2021

## Një fitore historike për personelin e kujdesit në Zvicër

Pas duartrokitjes pason edhe një mirënjohje për personelin e kujdesit dhe infermier\*et: mbi 60% votuan për nismën e kujdesit. Është hera e parë, që aprovohet një nismë e qarqeve sindikaliste. Tani Qeveria Federale dhe parlamenti duhen të kujdeset për financimin e kujdesit, kushte të mira pune dhe më shumë personel, për të siguruar e garantuar një kujdes të mirë.

Marek Wieruszewski

Shumë persona kujdestar kanë vendosur të lënë profesionin para kohe. Parasëgjithash arsytet janë kushtet e pavolitshme të punës. Nisma e kujdesit mund të ndryshojë këtë gjendje dhe kërkon planifikim të qëndrueshëm të orarit dhe shërbimit, struktura dashamirëse familjare dhe mundësi zhvillimi profesional. Unia do të shoqërojë zbatimin e nismës së kujdesit në mënyrë kritike dhe edhe më tej të rritë angazhimin për kërkesat e nismës karshi politikës dhe punëdhënësve.

## Asnjë gjyqtar:e federal:e të lotarisë

Niska kërkonte, që në të ardhmen të anulohen gjyqtar:et

federal:e. Nisma kontroverse është iniciuar e financuar kryesisht nga Adrian Gaser, njëri nga 300 njerëzit më të pasur e Zvicrës. Ai arriti të bindte vetëm 32%.

## Ligji Covid-19: Po e qartë.

Kundër ndryshimeve të 19 marsit 2021 u ndërmor referendumi. Kjo është arsyeja që zvicëran:et si të vetm:et në të gjithë botën të votonin mbi një ligjin për Covid-in dhe certifikatën e vaksinimit. Rezultati ishte i qartë: 62% janë të gatshëm për masat, të cilat duhet të reduktojnë numrin e viktimave.

## Integresso – Gati për ngritje në profesion!

**A je duke punuar në gastronomi në Kanton të Bernës apo Cyrihut dhe donë të ngjitesh në vend të punës?**

Marília Mendes

## Në programin arsimor të Integresso janë paraparë:

- Një vlerësim i pozitës. Me këtë rast do të përmbledhen përvojat dhe shkathësitë e deritashme dhe do të bëhet një plan i aksionit për trajnim-arsimimim e mëtejme (15 leksione)
- Orientimi dhe këshillimi profesional nga këshilltar\*et profesional\*et të rrugëtimit profesional (20 leksione)
- Përvetësimi i aftësive bazë në fushat e mëposhtme (sipas nevojës):
  - Përmirësimi i njohurive në gjermanisht: leximi, shkrimi dhe aftësia verbale e të shprehurit
  - Njohuritë bazë në matematikë
  - Përdorimi i teknologjisë informative dhe komunikuese
- Stërvitje e vazhdueshme e individuale (5 orë)

Eja në tubimin tonë informues!

Në Bernë: Të hënën, 17.01.2022, 15.00 – 16.00 h,

ECAP Bern, Freiburgstrasse 139 c, 3008 Bern

Në Biel: Të mërkurën, 19.01.2022, 18.00 – 19.00 h,

ECAP Biel, Spitalstrasse 11, 2502 Biel

Në Cyrih: Të hënën, 24 janar 2022, 15.00 – 17.00 h,

dhe të mërkurën, 26 janar 2022, 18.00 – 20.00 h,

Unia Zürich-Schaffhausen, Stauffacherstrasse 60, 8004 Zürich

Informacionet dhe lajmërimi: ECAP Bern dhe Biel,

Jadranka Soldo, T 031 381 81 33, info@ecap.ch,

ECAP Zürich, T 043 444 68 88, infozh@ecap.ch, www.integresso.ch


Fillimi i kursit dhe kostoja

Kurset fillojnë në shkurt 2022 në vazhdimësi në rast të lajmërimeve të mjaftueshme.

Pjesëmarrësit paguajnë për gjithë kursin arsimor CHF 250.–,

Anëtarët e Unia-paguajnë vetëm CHF 100.–.

## Intervista



## «Operacioni Papyrus: kombinimi i suksesshëm»

Përmes Operacionit «Papyrus» mes viteve 2017 dhe fundi i 2018 në Gjenevë janë rregullarizuar 3000 njerëz. Ky aksion është përgatitur për shumë vite nga Kantoni Gjenevës, nga Sekretariati Shtetëror për Migracion, nga organizatat e bazës dhe sindikatat. Tanimë është në dispozicion një analizë në formë libri. Horizonte bisedoi me bashkë-autoren Martine Schweri, pas prezantimit të librit në komisionin e migracionit të Unia.

## Martine, përse ke shkruar ti dhe Laurence Bolomey këtë libër?

Kjo libër është bërë me vetiniciativën tonë. Ne e kemi shkruar atë në kohën tonë të lirë, krahas punëve tona përkatëse. Qëllimi ynë ishte që tu japim mundësinë e shprehjes të angazhuarve të ndryshëm: Njerëzit pa status të rregulluar qëndrimi, vullnetarë, që janë angazhuar në vend, njerëz, që kanë kultivuar historitë e SansPapiers. Është një libër që është «shkruar me vesh». Me vesh, pasi që bëhet fjalë për dëgjim dhe bërjen me zë. Ne shpresojmë, që libri do të inspirojë aksione të ngjashme rregullarizuese nëpër kantonet tjera.

## A ka arritur qëllimet e veta «Papyrusi»?

«Papyrusi» kishte tri qëllime: Së pari legalizimi i njerëzve, pa ndërruar ligjin dhe rregulloret përkatëse dhe sipas kriterëve të përpikta. Ne përjetuam një ndryshim të vërtetë përmes këtyre kriterëve, të cilat nuk linin hapësirë për interpretime. Së dyti, kantoni dëshironte të kontrollonte dhe përmirësonte sektorët e prekur nga puna në të zezë dhe dumpingu në paga. Dhe së fundi: Personat në amvisnit private do të mund të integrohen në tregun e punës edhe falë shpalljeve për vende pune.

## Cilët ishin faktorët e suksesit?

Vullneti politik dhe angazhimi i partnerëve në Gjenevë ishin prezent. Edhe aftësia, për të punuar bashkërisht në një projekt të llojit të ri. Vendimtare ishte edhe puna konkrete e sindikatave dhe shoqatave. Ato kompletin dosjet, të cilat ju paraqiteshin Entit për migracion dhe të cilat duhej të ishin të përsosura. Ata caktonin orë të veçanta konsultimi, u drejtoheshin aktivist\*eve... një angazhim solidariteti në vend, të cilat mundësonin suksesin e operacionit. Për të siguruar dëshmitë e kërkuara nuk ishte gjithmonë e thjeshtë, pasi që shumica nuk kishin dëshmi apo nuk i posedonin më si dhe nga rasti në rast duhej kthyer deri në 5 apo 10 vite prapa. Edhe dëshmia e njohurive të mira të gjuhës frënge për disa ishte e vështirë dhe kurset e gjuhës si dhe kapërcehej numri i lajmërimeve për provim.

## Në dhjetor 2020 Qeveria Federale publikoi raportin mbi problematikën e SansPapiers, në të cilën deklaroi se «sistemin aktual e sheh si të përshtatshëm»...

Përgjigja e Qeverisë Federale në postulatit e Komisionit për Politikën Shtetërore është zhgënjyese. Praktike tenton që, sikur në Gjenevë ashtu edhe në Sekretariatit Shtetëror për Migracion, të ashpërsohet. Shoqatat duhet të luftojnë, për tu mos kthyer në «rregullat e vjetra». Në të vërtetë kontaktet me autoritetet politike dhe administrative është duke vazhduar, edhe pse aktualisht bisedimet janë shumë të vështirësuar.

Në kantonet tjera kishte përpjekje në rrafshin parlamentar, kantoni Waadt/Vaud duket të jetë këmbëngulës... mirëpo situatat nuk është gjithmonë e krahasueshme. Ka përpjekje të fuqizohen lejet e qytetit (Cyty Cards). Ato mundësojnë qasje në shërbimet komunale, mirëpo jo të drejta të vërteta. Kriza shëndetësore bëri të qartë, se sa është i rëndësishëm rregullarizimi i SansPapiers-eve, për tu mundësuar qasje në shërbimet shoqërore. Një rregullarizimi i lehtësuar për njerëzit, të cilët janë kohë të gjatë dhe janë integruar mirë këtu, është me rëndësi jetike. Pasi për ta është e komplikuar, të bëjnë të vlefshme të drejtat e tyre, dhe nuk është e drejtë për një shoqëri si kjo e jona, të sigurohet një jetë komode në kurriz të njerëzve tjerë.

*Një projekt inspirues për kantonet tjera! Libri i Martine Schweri dhe Laurence Bolomey, Papyrus - La combinaison gagnante (Shtëpia botuese Slatkine, 2021)deri më tani është në dispozicion vetëm në gjuhën frënge. Përkthimet në gjermanisht dhe italisht do të ishin më shumë se sa të dëshirueshme!*

Marie Saulnier Bloch

## Ju pyesni, Unia përgjigjet

### Mbrojtja në punë e të rinjve: A është e lejuar një ditë pune 10 orësh për të rinjtë?

Unë jam 17 vjeç dhe jam duke ndjekur arsimimin e zanatit si shitës në një shitore mode. Të enjten tek ne është mbrëmje shitjeje deri në ora 21. Në raste të tillë unë punoj gjithmonë 10 orë në ditë, dhe atë nga ora 8 – 12 dhe në mbrëmje nga ora 15 – 21. Kjo është mjaft e rreptë. Për shkak që unë kam një rrugë të gjatë për tek vendi i punës dhe lidhje të këqija komunikacioni, unë nuk mund të shkoj në shtëpi gjatë drekës. A lejohet fare një ditë pune 10 orësh?

**Myriam Muff:** Jo. Në ligjin zviceran të punës për punëmarrësit në moshë të re ka rregulla të veçanta mbrojtëse: Dita e punës sipas Nenit 31 të Ligjit të Punës mund të zgjat më së shumti 9 orë. Si të rinj vlejnjë të gjithë personat deri në mbushjen e moshës 18 vjeç. Orari më i lartë i orëve të punës vlen pa përjashtim, pra edhe atëherë, kur duhet kryer punë urgjente, apo kur papritur duhet kryer punë të shumta. Vendi ku ju mësoni zanatin bënë shkelje kundër rregullave të detyrueshme ligjore edhe në një pikë të mëtejme: Tek të rinjtë, dita e punës duhet të jetë brenda një kornize kohore 12 orësh. Mirëpo, mes orës 8 të mëngjesit dhe orës 21 në mbrëmje janë 13 orë. Nëse të enjteve filloni të punoni në ora 8, atëherë dita e juaj e punës duhet të përfundojë në ora 20. Pra, ju gjithsesi duhet të bisedoni me shefin tuaj dhe të kërkonti nga ai që menjëherë ti respektoi rregullat e vlefshme ligjore mbi orarin e punës edhe në raste të shitjeve në mbrëmje.

(Work, 5.11.2021)

### Pagesa e kompensimit: Pak të ardhura shkak i të ardhurave të ndërmjetme?

Unë jam i papunë dhe rishitas kam mundësinë të filloj një punësim të përkohshëm me të ardhura të ndërmjetme. Unë jam i gëzuar që mund të filloj përsëri punën, megjithatë shtrou pyetjen se a ka kuptim në aspektin financiar. A rezikoi unë me të ardhurat e mija të ndërmjetme gjobim në të ardhurat e mija aktuale?

**Nicole Debrunner:** Jo. Me rastin e të ardhurave të ndërmjetme ju keni edhe më tej të drejtë në kompensim të të ardhurave të humbura. Të ardhurat e humbura janë diferenca mes pagës nga fitimi i përkohshëm i ndërmjetmë dhe pagës së siguruar. Është mirë të dihet: Të ardhurat e ndërmjetme duhet që paguhet së paku sipas të ardhurave në profesionin dhe vendin përkatës. Nëse për një vend pune të plotë apo të pjesshëm fitoni më pak se sa keni të drejtë kompensimit nga arka e sigurimit të papunësisë, ju keni të drejtë në kompensim përkatës. Këto kompensonë 70 ose 80 për qind të humbjes së të ardhurave, varësisht shkallës së kompensimit ditor. Një shembull: Paga e siguruar është 5000 CHF. Ju do të merrni 70 ose 80 për qind të këtij përfitimi nga sigurimi i papunësisë pa të ardhurat e përkohshme, pra 3500 ose 4000 franga. Nëse do të fitoni të ardhura të ndërmjetme prej 2000 frangave, humbja e fitimeve arrin në 3000 franga. Sigurimi i papunësisë nga kjo do t'ju rimburojë ose 2100 CHF (70 për qind kompensim ditor) ose 2400 CHF (80 për qind kompensim ditor). Prandaj, fitimet e ndërmjetme së bashku me pagesën e kompensimit janë gjithmonë më të larta se vetëm përfitimi i thjeshtë i papunësisë

(Work, 1.10.2021)

### Sigurimi pensional i pleqërisë: A mund ti kontrolloi kontributet e AHV/AVS?

Në vitet e fundit më është dashur shpesh të ndërroi vendin e punës. Nga firma ime e fundit kam dëgjuar, se në ndërkohë kanë lajmëruar falimentimin. Unë kam marrë gjithmonë pagën time. Mirëpo jam i pasigurt, se a janë paguar kontributet në sigurimet shoqërore (p.sh. AHV/AVS). A mundem und fare ta kontrolloi këtë vet?

**Regula Dick:** Po. Pikërisht nëse keni ndërruar shpesh vendin e punës. Apo keni punuar në ndërmarrje, e cila ka dëshmuar vështirësi pagese, kjo ka shumë kuptim. Ju duhet të kontrolloni çdo 4-5 vjet, se a ka deklaruar punëdhënësi juaj pagën tuaj tek zyra e kompensimit dhe ai i ka paguar kontributet. Tek AHV/AVS, kontributet e papaguar mund të paguhet në mënyrë retroaktive vetëm gjatë 5 viteve prapa. Nëse nuk është deklaruar paga dhe nuk janë paguar kontributet, krijohet zbrazëti kontributësh. Kjo ka si pasojë, që më vonë pensioni juaj i pleqërisë të jetë i ulët. Se a është deklaruar paga juaj dhe a janë paguar kontributet, mund ta mësoni, duke kërkuar tek zyra e kompensimit të AHV/AVS ekstraktin falas të llogarisë tuaj individuale.

Informata mbi këtë, se si mund ta porositni ekstraktin në fjalë i gjeni në vegën vijuese (në gjuhën gjermane): Bestellung Kontoauszug | Merkblätter & Formulare | Informationsstelle AHV/IV (ahv-iv.ch). Nëse nuk e dini tek cila zyrë kompensimi ju ka siguruar punëdhënësi juaj, ekstraktin mund ta kërkonti edhe nga ndonjë zyrë tjetër e kompensimit, fjala bie nga ajo e kantonit tuaj. Nëse në ekstrakt e shihni se punëdhënësi juaj nuk e ka deklaruar pagën tuaj, kërkonti që brenda 30 ditësh të korrighet ekstrakti. Dërgojani zyrës së kompensimit kopjet e dëftësave tuaja të pagës për të ardhurat, të cilat nuk duken në ekstrakt, si dhe një kopje të kontratës së punës.

(Work, 19.11.2021, angepasst)



## Të drejtat e punëtorëve dhe organizimi sindikal

# Interesat e ngushta në vend të solidaritetit kolektiv

Numri i sindikatave në Kosovë është rritur në periudhën e pasluftës. Sa përkon kjo rritje me të drejtat e punëtorëve? Sa është përmirësuar gjendja e punonjësve? Cili është imazhi i sindikatave sot në Kosovë? Një vrojtim kritik dhe dashamirës!

Osman Osmani

Në vitin 2017, në Kosovë janë të regjistruara 208 shoqata sindikale dhe 28 sindikata të pavarura. Megjithatë, kushtet e punës, veçanërisht e atyre në sektorin privat, janë të këqija, ndërsa pozita e punonjësve është tejet e pasigurt dhe e pa perspektivë. Hululimet e shumta japin një pasqyrë shqetësuese për tregun e punës në Kosovë. Si problem kryesorë shihet politizimi i lartë në Kosovë, sidomos kur bëhet fjalë në shanset për punësim dhe ngritje profesionale në të mirë të ekonomisë kosovare dhe mirëqenies sociale.

Në një intervistë të organizuar nga Instituti i Kosovës për Politika Zhvillimore (artikull nga Mr. sc. Blerim Burjani: <http://www.ekonomia-ks.com/sq/opinion/punesimi-ne-sektorin-publik-dhe-privat>), 85% e qytetarëve janë deklaruar se për ta fituar punësimin në sektorin publik duhet patjetër t'u takosh partive politike në pushtet dhe rreth 65% e kanë ndërruar partin politike për çdo mandat të qeverisjes për të gjetur punë në sektorin publik. Shërbimi civil mbetet sektori më i ndjeshëm. Askush nuk është i bindur në Kosovë se i beson ndonjë paneli punësimi, në mënyrë objektive, sepse të gjithë mendojnë se «njohuria» dhe partia janë segmentet themelore të punësimit në vend kur flasim për sektorin publik. Askush nuk beson se respektohen kriteret ligjore. Diskriminimi i parë bëhet me rastin e hartimit të konkursit dhe përshkrimit të vendeve të punës. Aty hartohen kriteret duke iu përshtatur personave të caktuar. Gjendja aspak më e mirë dhe e mjerë është edhe në sektorin privat, në disa kompani private punëtorët shfrytëzohen tmerrësisht nga 12 orë punë në ditë apo në kompanitë private të sigurimit të objekteve ka shumë të punësuar që punojnë pa ndonjë shpërblim shtesë për punën e natës dhe ka të punësuar edhe punëtorë nën moshën 20 vjeçe dhe forma e pagesës në orë punë është mjaft diskriminuese.

### Jeta e shtrenjtë, pagat e ulëta rritin borxhet private

Të dhënat e nxjerra nga raportet e Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe hululimet e ndryshme tregojnë se gjendja e punëtorëve në Kosovë është e mjerueshme, sidomos në sektorin privat. Pagat e turpshme (170 Euro), orari i stërzgatur i punës, ngarkesa për shëndetin, rrezikimi i jetës, mungesa e respektit ndaj djersës së atyre të cilët krijojnë profite për shëfat e tyre. Duke marrë parasysh koston e lartë të jetesës dhe pagat e ulëta, nuk befason fakti se populli ynë është i zhytur në borxhe nëpër banka, persona privat dhe detyrohen të shesin pasurinë e patundshme për të siguruar mbijetesën. Sipas Institutit të Kosovës për Politika Zhvillimore, çdo i dyti qytetar i punësuar në sektorin publik dhe atë privat është me obligime kreditore, ndërsa bankat vazhdojnë të përfitojnë më së shumti me kamata marramendëse dhe çmime të paarsyeshme për shërbime bankare.

### Momenti i fundit për veprim kolektiv dhe solidar nga sindikatat

Duke i pa problemet e shumta për punonjësit në Kosovë, fokusi i sindikatave, si organizata solidariteti, duhet të përqendrohet në përmirësimin e kushteve të punës dhe sigurisë në punë për të gjithë. Një sindikatë fokusohet në përmirësimin e të drejtave të anëtarëve të saj, kjo është natyra e tyre. Forca sindikale rritet dhe ngjallet në luftën solidarë edhe për punonjësit tjerë. Andaj, besoj se në fokus të sindikatave në Kosovë duhet të qëndroj përmirësimi i kushteve të punës në degët më të rrezikuara të ekonomisë në Kosovë, sidomos në sektorin privat, sepse çdo ditë nëpër kantieret e ndërtimit vdesin të rinj e të reja, punëmarrës familjarë, në mungesë të sigurisë. Pagat janë në krahasim me sektorin publik shumë më të ulëta. Pra, fillimisht nevojitet solidarizim për përmirësimin e pagave në sektorin privat, të cilat janë tejet të ulëta.

### (Mos)Organizimi sindikal në Kosovë

Njëri ndër problemet kryesore të organizimit sindikal në Kosovë, pas mungesës së organizimit kolektiv në vend, është dëshmuar mungesa e reformave në sindikata në pajtueshmëri me ndryshimet sistimore, pastaj mungesa e solidaritetit në mesin e punëmarrësve dhe sindikatat e copëtuara, në krye të cilave



të janë «dinosaurët» (kryesues të tej moshuar me autoritet zyrtari). Pastaj, pjesëmarrja e krerëve sindikalist në procesin e privatizimit, jo për të ruajtur pasurinë e të mirën publike e shoqërore, por për të marrë pjesën e kulaçit nga plaçka në kurrriz të pasurisë publike. Duke reduktuar kështu organizimi sindikal vetëm në një grup të ngushtë interesi, i atyre që janë në krye të tyre. Pasiviteti sindikal nuk mund të arsyetohet vetëm me deklarata për atdhedashuri e shtet ndërtim, por edhe me angazhimin për një shoqëri sociale, për kushte të mira të punës, paga dinjitoze dhe jetë të mirë për të gjithë.

Lufta për më shumë paga është e arsyeshme, por duhet të operohet me kujdes dhe në përputhje me gjendjen në vend. Nëse Sindikata e Arsimit kërkon paga më të mira për punonjësit e tyre, kjo është kërkesë legjitime, por jo edhe patjetër e arsyeshme në kontekstin shoqëror. Sipas Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, gjendja e arsimit në Kosovë nuk është përmirësuar dhe vazhdon të jetë në zonë kritike dhe se «ka një stagnim në fushën e arsimit, jo vetëm në çështjet e buxhetit, por edhe në të organizimit». Kërkesat për paga dhe kërcënimi me grevë në këto kushte pandemie dhe duke marrë parasysh pagat relativisht të mira në këtë sektor në krahasim me punëtorët e sektorit privat, atëherë kërkesat dhe veprimet e tyre mund të jenë shumë kundër produktive. Mësimdhënësit, të cilët kërcënojnë me grevë, rrezikojnë të hidhërojnë opinionin e gjerë dhe sidomos prindërit, të cilët brengosen si për nivelin e ulët të cilësisë së arsimit ashtu edhe për faktin se me mbyllje të shpeshta, fëmijët humbin shumë nga njohuritë shkollore. Pas mbylljes së kohëpaskohshme të shkollave shkak i pandemisë, të kërcënosh me grevë dhe mbyllje të shkollave, është akt marrëzie e jo e forcës sindikale, sepse kjo i bie si bumerang në kokë vetë sindikatave, siç po tregojnë edhe në reagimet e shumta publike edhe në rrjetet sociale, sa herë të bëhen deklarime kërcënuese me grevë.

Humbja e besimit në shoqëri paraqet një problem të madh, i cili nuk mund të riparohet shpejtë. Shkatërrimi i besimit në sindikata për oportunitete politike është i papranueshëm dhe duhet të ndalohet nga vetë baza, pra nga vet punëtorët, në këtë rast mësimdhënësit. Keqpërdorimi i detyrës si udhëheqës sindikal për politikë ditore, duhet të merr fund.

### Sindikatat në Kosovë duhet reformuar e fuqizuar

Vetëm me sindikata të forta dhe shoqata të punëdhënëseve të afta për të negociuar, partnerët socialë mund të negociojnë dhe zbatojnë zgjidhje të qëndrueshme e të përgjithshme (kontrata kolektive të punës, marrëveshjet kolektive). Këto krijojnë bazamentin për paga të mira dhe të drejta dhe kushte të mira dhe të sigurta të punës si dhe zhvillimin e një sistemi të fortë të aftësimi profesional. Pos tjerash ne presim që qeveria e Kosovës të futë pagën minimale, premtim ky i saj në fushatën zgjedhore. Ne, sindikalist\*et shqiptaro-zviceran, kemi dhënë sugjerimet tona për reformë sindikaliste në Kosovë dhe bashkë me partnerët tanë në Zvicër e Kosovë jemi të gatshëm që së bashku ti hyjmë kësaj sfide. Topi tani është në duar të drejtuesve të sindikatave në Kosovë.